



Republika e Maqedonisë së Veriut



Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore,
Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup

Në bazë të nenit 20-g nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 143/19 dhe 14/20), 37-gj nga Ligji për ndërmarrjet publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18 dhe 35/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr. 275/19),, nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 nga Ligji për marrëdhënie të punës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 110/19, 267/20),, Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut- Shkup, me seli në rrugën “Jordan Mijallkov nr. 50b, Shkup, Qendër” publikon:

KONKURS PUBLIK numër 2/2021

për punësim për kohë të pacaktuar të 2 (dy) personave ndihmës-teknik, grupi IV,
nëngrupi 1dhe 5 për vendet e punës në vijim:

1. KDP0401A03004 - Pastrues i hapësirave zyrtare, grupi për mirëmbajtjen e higjienës, Reparti për mirëmbajtjen e ndërtesave stacionare, Sektori për siguri dhe mirëmbajtje të ndërtesave, 1 realizim

Kushtet e përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për realizimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushte të veçanta:

- më së paku nivel të kualifikimit I ose arsimim fillor,
- me ose pa përvojë pune.

Orari i punës:

- ditët e punës e hënë – e premte
- orët javore të punës 40
- orari i punës prej orës 08:00 deri në orën 16:00,
- shuma e rrogës neto: 16.134.00 denarë

Punësimet e parashikuara në pajtim me planin vjetor në institucion për vitin 2021 janë: Maqedon(ase) 1.

2. KDP0405A03001 –Korrier, Reparti për komunikime, reparte të pavarura, 1 realizim.

Kushtet e përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushte të veçanta:

- më së paku nivel të kualifikimit III, 180 kredi sipas ECVET ose Sistemit kreditor të Maqedonisë për sistem të përgjithshëm ose arsimim trevjeçar të mesëm,
- me ose pa përvojë pune
-

Orari i punës:

- ditët e punës e hënë – e premte
- orët javore të punës 40
- orari i punës prej orës 08:00 deri në orën 16:00
- Shuma e rrogës neto: 16.134.00 denarë

Punësimet e parashikuara në pajtim me planin vjetor në institucion për vitin 2021 janë: Maqedon(ase) 1.

Dëshmitë për plotësimin e kushteve duhet të jenë në formë origjinale ose kopje e verifikuar në noter.

Punësimi do të jetë për kohë të pacaktuar.

Kushtet e theksuara në konkurs, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Afati për aplikimin e kandidatëve është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 45,90 ose 120 ditë pas skadimit të afatit për aplikim, në varësi nga numri i aplikimeve të paraqitura

Personi për kontakt: Sllavica Popovska,

Numri kontaktues: 02/2449-007.

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për punësim me dorëzimin e aplikimit të punësimit me kontakt të të dhënave dhe dokumente/ dëshmi për plotësimin e kushteve në adresën e Ndërmarrjes Publike: Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, rr. “Jordan Mijallkov”, nr. 50b -1000 Shkup ose në librarinë e Ndërmarrjes Publike: Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, me titullin “për konkursin publik për aplikimin e kandidatëve për punësim”.

(FORMULARI I APLIKIMIT MUND TË MERRET NGA UEB FAQJA www.mzi.mk ose nga Libraria e Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut- Shkup).

Kandidatët janë të obliguar që formularin e aplikimit ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë precize, me të dhëna të sakta dhe deklaratë të dhënë me përgjegjësi materiale dhe penale me të cilën kandidati konfirmon se të dhënat e aplikimit janë të sakta, ndërsa dëshmitë e dorëzuara të jenë origjinale ose kopje e origjinalit.

Dokumentacioni i paplotësuar dhe i padërguar në kohë nuk do të merret parasysht gjatë shqyrtimit të aplikimit.

Procedurën për zgjedhje të kandidatëve do ta zbatojë Komisioni për selektim, i formuar nga ana e drejtorit të Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore, Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, që përbëhet nga kontrollimi i të dhënave të futura në aplikimin për punësim dhe kontrollim i dëshmimeve të dorëzuara.

Pas mbarimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, për zgjedhjen e bërë, secili kandidat do të njoftohet me shkrim.

Ndërmarrja Publik për Infrastrukturë Hekurudhore, Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut- Shkup